

A K T T H E M E L I M I D H E S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " MEBELLI TRANS " SHPK

TITULLI I

Data e themelimit, Emërtimi, Objekti, Kohëzgjatja, Zyra Qendrore, Forma dhe Vula e shoqërisë

Neni 1:

Data e themelimit, Emërtimi dhe Themeluesit

Shoqeria " **MEBELL TRANS** " SHPK, krijohet ne date 16.03.2021 nga ortaku i vetem z. Denis Mebelli i biri i Eduart-it, i dtl. 18.02.1992 lindur dhe banues ne Lushnje, Lagja " 18 Tetori ", identifikuar me karte identiteti 033076696 dhe nr. Personal: J20218105P , madhor e me pergjegjesi te plete per te vepruar.

Neni 2:

Personaliteti juridik

2.1 Shoqëria është person juridik shqiptar.

2.2 Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2.3 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në perputhje me legjisacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

Neni 3:

Forma e shoqerise

3.1 Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, SHPK derisa me vendim të ortakut të vetëm të vendoiset ndonjë formë tjeter ligjore.

Neni 4:

Objekti

4.1 Shoqëria " **MEBELL TRANS** " SHPK do të ketë si objekt të veprimtarisë:



- Sherbime transporti mbi rrota, ne rruge detare dhe tokesore, Brenda dhe Jashte territorit te Republikes se Shqiperise, transport kombetar dhe nderkombetar, Transport per vete dhe per te trete.

- Sherbim transporti per, mobilje, orendi, pajisje shtepiake, zyrave dhe/ose ambienteve te ndryshme tregtare, barnave apo medikamenteve mjekesore, pajisje elektrike dhe elektronike, elektroshtepiake, mallra ushqimore dhe/ose ushqimore te gatshme dhe gjysem te gatshme, bujqesore dhe blektorale qofshin keto edhe prodhime ne forme produktesh te konservuara, veshmbathje, industriale te perdorimit te perditshmem, kozmetike, detergjente, artikuj sportive, lende te para per industrine, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, pajisje zyrash dhe kancelari, pjese kembimi auto e makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike, vajra lubrifikante, e te tjera, si dhe tregtimin e tyre Brenda dhe jashte vendit me shumice e pakice.

- Sherbim transporti per mallra industrial, produkte bujqesore dhe blektorale si dhe te lendeve te para per produkte bujqesore dhe blektorale, transportin e makinerive bujqesore dhe te makinerive qe perdoren per prodhimin dhe perpunimin e materialeve industriale.

- Grumbullim I mbetjeve urbane te pa rreziksheme per qellime riciklimi, seleksionimi, copetimi mekanik, amballazhimi dhe eksportimi I tyre.

- Tregtimin e te gjithe artikujve te mesiperme me shumice e pakice per llogari te vet shoqerise si dhe per llogari te te treteve.

- Shoqeria pervec, sa me siper, mund te ushtroje veprimtari tjeter te lejuar nga ligji dhe/ose pjesmarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar e krijuar ne baze te legjisacionit shqiptar.

- Te krijoje filiale dhe zyra perfaqesie ne qytete te tjera te shqiperise ose ne shtete te tjera, ne perputhje me legjisacionin e tyre.

Per permbushjen e objektit te veprimatrise , shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekt te njejtë ose te njashhem me te sajin dhe mund te kryeje direkt apo indirekt te gjitha operacionet tregtare, finaciare me karakter te luajtshem apo te paluajtshem.

Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo valuta te tjera, prane bankave shqiptare apo te huaja, duke disponuar lirisht mjete monetare te akumuluara ne to, konform legjisacionit ne fuqi.

Neni 5:

Kohëzgjatja

5.1 Shoqëria " **MEBELLİ TRANS** " SHPK kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Ortaku i vetëm.



5.2 Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Ortakut të vetëm të vendoset prishja e shoqërise ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6:

Selia

6.1 Selia kryesore e shoqërise do te jetë në Lushnje, Lagja "18 Tetori " Pasuria me numer 19/42 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 8572, Lushnje. Me vendim te Ortakut të vetëm selia e shoqërise mund të ndryshohet, mund të hapen degë, dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 7:

Vula e Shoqërisë

7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj, duke shënuar në të emërtimin tregtar ose iniciale.

Titulli II Kapitali

Neni 8:

Kapitali Themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqërise do te jetë 100 (Një qind) Leke, i zotëruar 100 % nga ortaku i vetëm z. Denis Mebelli.

8.2 Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetëm i shoqërisë. Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të ortakut të vetëm.

8.3 Kapitali themeltar i shoqerise **MEBELLİ TRANS** sh.p.k perbehet vetem nga kontribute ne para dhe eshte 100 (Një qind) Leke. Kapitali themeltar perbehet nga 1 kuote me vlerë 100 lek, te cilat zoterohen nga ortaku I vetem z. Denis Mebelli.

8.4.Ortaku i vetëm ka të drejtë ta tjetërsoje këtë kapital, ta shtojë ose ta pakësojë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuar me ligj.

8.5 Ortaku i vetëm miraton llogaritë, nëse është e nevojshme, pas raportit të ekseprteve kontabël të autorizuar brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finanziar, merr vendim për ndryshimet që mund të pësojë statuti, për ndryshimet e masës së kapitalit themeltar dhe shndërrimin e shoqërise



në një formë tjetër, për punësimin e punonjësve dhe pagat, si dhe probleme të tjera të lidhura me punësimin ne zbatim te legjisacionit shqiptar. Vendimet e ortakut të vetëm evidentohen në një regjistër.

Neni 9:

Kuotat, të drejtat e lidhura me to:

9.1 Cdo kuotë jep të drejtën e një vote për të marre vendime sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare". Të gjitha votat do të ushtrohen nga ortakët sipas zotërimeve.

Neni 10:

Kuotat. Fitimi, Transferimi i kuotave

10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit, apo cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Titulli III Administratori

Neni 11:

Administrimi i shoqërisë

11.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i zgjedhur nga Ortaku i vetem. Administrator i shoqërise do të jetë z. Denis Mebelli i biri i Eduart-it, i dtl. 18.02.1992 lindur dhe banues ne Lushnje, Lagja " 18 Tetori ", identifikuar me karte identiteti 033076696 dhe nr. Personal: J20218105P.

Afat i ushtrimit te detyrës është 5 (pese) vjet me të drejtë ripërtëritje.

Neni 12:

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit. Përgjegjësitë

12.1 Administratori ushtron kompetencat e mëposhtme:

1. Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Ortaku i vetem.



2. Vepron me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërise brenda kompetencave të parashikuara në statut apo/dhe në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
3. Pasi ka marre miratimin e Oratkut te vetem, kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë.
4. Jep urdhra dhe udhezime punëmarresve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në perputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e rendshme të shoqërisë;
5. Drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
6. Raporton para Ortakut të vetëm sa herë që ai e kerkon si dhe në rastet kur është i nevojshëm raportimi në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
7. Zbaton vendimet e marra nga Ortaku i vetem;
8. Paraqet në mënyrë të rregullt dhe në kohë te përshtatshme Ortakut të vetëm, reportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogaritë vjetore si dhe përgjigjet për to.
9. Ushtron të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
10. Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit, sipas parashikimit të ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Neni 13:

Mbarimi i mandatit te Administratorit

13.1 Mandati i Administratorit përfundon:

- me mbarimin e afatit;
- me shkarkimin e tij nga ortaku i vetëm
- kur vetë Administratori jep dorëheqjen vullnetarisht.
- sipas menyrave të tjera parashikuar nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Titulli IV Viti Financiar. Prishja e Shoqërisë. Dispozitat e fundit.

Neni 14:



Viti Financiar

14.1 Veprimet financiare fillojne me 1 janar dhe mbyllen me 31 dhjetor të cdo viti, pavec vitit te parë që fillon ditën e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe përfundon në 31 dhjetor. Administratori merr masa lidhur me nxjerrjen e bilancit të hartuar konform ligjit mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

14.2 Ne perfundim te vitit ekonomik, pas aprovimit te bilancit, asambleja pasi ka ndare fondet per likujdimin e detyrimeve ndaj te treteve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rrezervat e detyrueshme, vendos per ndarjen e fitimit neto. Per humbjet per gjigjet ekskluzivisht shoqeria me kapitalin e saj. Fitimi i realizuar mund te transferohet lirisht jashte Shqiperise, konform legjislacionit ne fuqi.

14.3 Ortaket mund te zmadhojne kapitalin e tyre ne shoqeri, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqerise, konform parashikimeve ligjore dhe statutore.

Neni 15:

Mbarimi i Shoqërisë

15.1 Shoqëria mbaron:

1. Me vendim të ortakut të vetëm
2. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
3. Sipas shkaqeve të tjera të parashikuara nga ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 16:

Te ndryshme


16.1 Për cështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimi nga ky statut, gjejnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

16.2 Shoqëria "**MEBELL TRANS**" SHPK regjistrohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Ortaku I Vetem Themelues

z.Denis Mebelli

DENIS MEBELLI


7

DATA: 16 / 03 / 2021

DT: / / 2021